



K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. me seli ne Prizren

KOMPANIA RAJONALE E UJËS-JELLESIT
REGIONALNA KOMPANIJA ZA YODOSNABOJEVANJE

»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

2249

Ne bazë të Nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212. Kompania Rajonale e Ujës-Jellësit " Hidroregjioni Jugor " Sh.A. Prizren , me datë 09.09.2021 shpall:

Di. 09.09.2021
PRIZREN

KONKURS

Kompania: Kompania Rajonale e Ujës-Jellësit " Hidroregjioni Jugor " Sh.A. në Prizren
Pozita e punës: Depoist, 1 (një) në Njësia Punuese në Suharekë.
Paga: Koeficienti sipas Rregullorës së Kompanisë.

Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar)

- Përgaditja shkollore : Shkolla e mesme ekonomike apo gjimnazin e përgjithshëm
- **Përvoja e punës:** Se paku gjashtë muaj në lëmin përkatëse
- **Kushtet e veçanta:** Njohja e programeve Microsoft Office

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës
- Pranon në depo materialin, mjetet e punës dhe veglat e punës si dhe inventarin e nevojshëm për punën e njësisë
- Sipas kërkesave dhe urdhërësive të punëtorëve e jep materialin, mjetet dhe veglat e punës.
- Mban evidencën e rregullt të stoqeve në depo dhe e dorëzon raportin për këtë.
- Mban evidencën e ngarkesës me vegla të punës dhe mjeteve të punës nga ana e punëtorëve.
- Me rastin e pranimit dhe dhënies së materialit, veglave etj, përkujdeset për cilësi dhe sasinë e materialit të pranuar të dorëzuar dhe të kthyer.
- Bën ndarjen e materialit sipas llojit dhe dimensioneve.
- Mbanë me rregull kartelat e materialit me dorë apo me kompjuter.
- Përgatitet të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e depos dhe është i obligueshëm të jetë prezent gjatë punës së komisionit
- Është përgjegjës për deponimin e rregullt të materialit në depo, pranimin dhe dorëzimin e rregullt të mallit afarizmin material dhe financiar të depos si dhe për saktësinë e kryerjes së punës
- Kujdeset për rregullimin në depo.
- Përgjigjet për dëmtimin e paarsyeshëm të materialit.
- Kryen edhe punët tjera që i përkasin profesionit, në bazë të urdhrit të shefit të sektorit të cilit i përgjigjet
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të njësisë punuese.

Procedura e aplikimit:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe që bashku me aplikacion të bashkangjeshin edhe këto dokumente:

- Biografin(CV) e detajuar
- Letërnjoftim-kopje
- Letërmotivimi
- Diplomën e Shkollës mesme (Obligative diploma e noterizuar).
- Dëshmi mbi përvojen e sukseshme paraprake
- Dëshmi që nuk është nën hetim

Aplikacionet mund të tërhiqen në zyrën të K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. rr "WESLY CLARK" pn.Prizren
Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen në zyrë të shërbimit për punë juridike dhe të përgjithshme të mbyllura në pako. Dokumentet nuk kthehen.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit respektivisht deri me datën 23.09.2021 në ora 16:00.

K.R.U. " Hidroregjioni Jugor " – Prizren